



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

Nr. 1197/1 Prot.

Tiranë, më 22.07. 2022

VENDIM

Nr. 2, datë 15 / 07 / 2022

PËR

MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR”
ME QËLLIM NDËRTIMIN E STRUKTURAVE ANKORUESE,
PORTUALE NË DET, ME VENDNDODHJE: PORTI I VLORËS,
BASHKIA VLORË, QARKU VLORË

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit:

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes, “Për përdorim burimi ujor”, me qëllim ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale në det, me vendndodhje: Porti i Vlorës, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë, për Shoqërinë Koncesionare Marina Vlorë sh.p.k.
2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë:

Emri i burimit ujor: Deti Adriatik.

Vendndodhja e burimit ujor (KRGJSH):

Zgjerimi në kalatën perëndimore dhe dallgëthyesi

X1	456021.850	Y1	4479646.413	Z1	1.85 m.m.n.d
X4	455932.740	Y4	4479533.806	Z4	1.85 m.m.n.d
X7	455958.438	Y7	4479415.803	Z7	1.85 m.m.n.d
X12	456288.998	Y12	4479342.782	Z12	1.85 m.m.n.d

Platforma A

X1	456047.117	Y1	4479753.986	Z1	0.75 m.m.n.d
X2	456336.248	Y2	4479686.073	Z2	0.75 m.m.n.d

Platforma F+B

X1	456032.711	Y1	4479692.655	Z1	0.75 m.m.n.d
X3	456240.068	Y3	4479643.950	Z3	0.75 m.m.n.d

Platforma C+G

X1	456018.648	Y1	4479632.784	Z1	0.75 m.m.n.d
X3	456226.005	Y3	4479584.079	Z3	0.75 m.m.n.d

Platforma D+H

X1	456007.901	Y1	4479587.029	Z1	0.75 m.m.n.d
X3	456194.814	Y3	4479543.126	Z3	0.75 m.m.n.d

Platforma E+I

X1	455994.753	Y1	4479531.053	Z1	0.75 m.m.n.d
X3	456181.666	Y3	4479487.150	Z3	0.75 m.m.n.d

Lloji i veprimtarisë që do të kryhet: Ndërtim i një porti turistik në qytetin e Vlorës “Marina Vlorë”.

- Gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të kësaj strukture, të lejohet kalimi i qetë i mjeteve lundruese që do të përdorin pjesë të tjera të gjirit jashtë objektit të koncesionit, të cilat nuk pengojnë aktivitetin e Portit dhe janë në përputhje me legjislacionin dhe udhëzimet/rregulloret/urdhrat përkatës në fuqi.
- Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI

EDI RAMA

**AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

GERTA LUBONJA